



Planuar / Doretuar Primijsno/Prodato Received / Delivery		12.09.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Nr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKDMSHCK	5337/2022		1/3	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.676/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr676/2022 të datës 29.07.2022 të parashtruar nga ankuesja nga fshati kundër organit të punësimit Agjencia për Informim dhe Privatësi, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 12.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

HEDHET POSHTË si e palejuar ankesa me numër A.nr.676/2022 e datës 29.07.2022 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në pozitën "Zyrtare Certifikuese" në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, me datë 23.06.2022 përmes e-mali i është drejtuar Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, me kërkesë për nivelizimin e pagës nga koeficienti tetë(8) në koeficientin nëntë (9), gjegjësisht që ti bëhet harmonizimi i koeficientit në pozitën përkatëse që ka si dhe ti behet rregullimi i përshkimit të detyrave të punës konform Vendimit të datës 27.11.2014 të Ministrisë së Administratës Publike, mirëpo ankuesja deri me datën 27.07.2022 nuk ka marr përgjigje nga organi i punësimit .

Ankuesja kundër heshtjes administrative me datë 27.07.2022 përmes postes së Kosovës me numër R2443271 ka parashtrua ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës e cila është pranuar me datë 29.07.2022, me pretendimin ankimore që ti bëhet harmonizimi i koeficientit si dhe rregullimi i përshkrimit të detyrave të punës komform pozitës .

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 05.09.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Agjencia e Informim dhe Privatësi. Ndërsa me datën 18.08.2022 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor administroj këto prova: Ankesën me numër të protokollit 4410/2022 të datës 29.07.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, përmes postes së Kosovës me numër R2443271 i datës 27.07.2022, e plotësuar me datë 16.08.2022; Vendim nr.120/2022 i datës 30.03.2022; Vendosje e koeficientit sipas pozitës përkatëse e datës 27.11.2017 nga DASHC/MAP; E-mail i datës 23.06.2022 kërkesë për nivelizimin e koeficientit drejtuar tek Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm në Agjencinë për Informim dhe Privatësi; Përgjigjja në ankesë e datës 18.08.2022 me numër të protokollit 4792/2022; Mendim Këshillues i datës 20.10.2021; Kërkesë e datës 27.09.2021 për mendim këshillues drejtuar Agjencisë për informim dhe privatësi-AIP; Rregullorja NR.01/2021 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në AIP; Ndryshim plotësim i akt emërimit i datës 01.04.2019; Akt emërimi nr. AE/009-2019 i datës 15. 07.2019 ; Akt emërimi nr.AE/006-2022 i datës 26.07.2019; Shkrese zyrtare e AIP-Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm-Zyrtari Certifikues; Lista e pagave e muajit qershor dhe korrik 2022; Përshkrimi i detyrave të punës nga sistemi NBNJ, i aprovuar nga DASHC/MAP, me kopje të konkursit të datës 17.03.2017; E-mail i datës 15.08.2022, nga Menaxherja e BNJ të AIP-së, për përgjigje në ankesë; E-mail i datës 24.06.2022- Kërkesë drejtuar tek NBNJ në AIP për nivelizim të koeficientit; Akt emërimi Nr.AE/020-2017 i datës 08.05.2017; Plani i veprimit i datës 23.05.2018 i menaxhmentit; Shkrese zyrtare e datës 26.04.2022, AIP-Zyra e Drejtorit të Përgjithshëm-Zyrtari Certifikues.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses

është e palejuar, sepse:

Ankuesja e punësuar në pozitën " Zyrtare Certifikuese" në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, me datë 23.06.2022 përmes e-mali i është drejtuar Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Informim dhe Privatësi, me kërkesë për nivelizimin e pagës nga koeficienti tetë(8) në koeficientin nëntë (9), gjegjësisht që ti bëhet harmonizimi i koeficientit në pozitën përkatëse që ka, mirëpo ankuesja deri me datën 27.07.2022 nuk ka marr përgjigje nga organi i punësimit dhe e pakënaqur me mos përgjigje dhe kundër heshtjes administrative me datë 29.07.2022 7 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës .

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pranueshmerinë e ankesës analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht nenit 98 paragrafi 1 dhe 2, ku përcaktohet se: 1. *Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure.* 2. *Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj, si dhe nenin 127 paragrafi 4 ku përcaktohet se: 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ,*



dhe konstatoi se në bazë të dëshmive të ofruara ankuesja më datë 23.06.2022 përmes e-mailit i është drejtuar Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Informim dhe Privatësi me kërkesë për nivelizimin e pagës nga koeficienti tetë(8) në koeficientin nëntë(9), ndërsa e pakënaqur me mos përgjigje nga organi i punësimit gjegjësisht me heshtje administrative ankuesja me datë 29.07.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Andaj Kolegji i Këshillit në bazë të shkresave të lëndës vlerëson se parashtrimi i ankesës nga ankuesja me datë 29.07.2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është e para afatëshme respektivisht ankesa është parashtruar ende pa përfunduar afati i përcaktuar ligjor për përfundimin e procedurës administrative prej dyzetepesë (45) ditëve ashtu siç përcaktohet me nenin 98 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative gjegjësisht ankesa është parashtruar në kundërshtim edhe me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet afati i parashtrimit të ankesës kundër heshtjes administrative, kështu që Kolegji i Këshillit duke u bazuar në faktet e lartcekura konstatoi se ankesa e ankueses është e palejuar në kuptim të nenit 125 paragrafi 1 dhe nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ME NUMËR A.nr.676/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Informim dhe Privatësi;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit